

I SHOQERISE TREGETARE PRIVATE "A D A " sh.p.k.

Unë Artur Gela, i biri i Bektashit, Datëlindja 1965, banues në Tepelenë, Lagja "Mustafa Matchiti" Pallati 36.
Mbështetur në nenin 251, shkronja "c", të ligjit Nr.7512 datë 10.08.1991 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, nismës së lirë të veprimtarisë private dhe privatizimit", krijoj shoqérinë tregtare private me përgjegjësi të kufizuar të quajtur "A D A " dhe hartoj këtë akt themelues si vijon:

F O R M I M I

Neni 1

Forachet shoqëria tregtare private e quajtur "A D A" sh.p.k. Shoqëria do ti nënshtronet legjislacionit shqiptar, ndërsa degët që mund të krijohen do ti nënshtronen legjislacionit ku do të ketë selinë dega.

Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të këtij akti themelues dhe statutit të shoqërisë që do të miratohet nga ortaku themelues.

VEND-QËNDRIMI I SHOQERISE

Neni 2

Vend-qëndrimi i shoqërisë tregtare private "A D A " sh.p.k. do të jetë në qytetin e Tepelenës, Lagja "Mustafa Matchiti", Pallati 36.

Shoqëria do të hapë edhe vend-qëndrime të tjera të dyta, degë, filiale, përfaqësi dhe agjensi, në të gjithë territorin e Republiëks së Shqipërisë dhe me miratim të organeve kopetante edhe jashtë vendit.



OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Neni 3

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj në fushën e:
-Tregëtimit të mallrave të nryshme industriale dhe ushqimore,
-Tregëtimit të atikujve elektroshtëpiaëe,
-Tregëtimit të artikujve bujqësore e blegtorale,
-Tregëtimit të karburanteve dhe lubrifikanteve,
-Transport për të tjerët,
-Me shumicë dhe pakicë dhe import eksport,për gjithë artikujt.

Neni 4

Për kryerjen e veprimitarise së saj, shoqëria do të hapë njësi tregëtimi, shërbimi dhe përpunimi dhe do të bashkëpunojë me persona fizikë dhe juridikë, vendas dhe të huaj.

KOHEZGJATJA E SHOQERISE

Neni 5

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar dhe mbi 10 vjet. Ajo mund të shpërbëhet në çdo kohë dhe për çfardo lloj shkaku.

KAPITALI I SHOQERISE


Neni 6

Kapitali filletar i shoqërisë private "A D A "sh.p.k. do të jetë 100.000 lekë dhe do të përbëhet nga kapitali i ortakut të vetëm, themelues të shoqërisë.

Kapitali filletar mund të shtohet ose të pakësohet sipas vendimit të ortakut.

Kuota e ortakut në kapital është e gjitha e emëruar dhe e pandashme.

Kapitali është tërësiaht i shlyeshëm dhe i nënshkrueshëm.



Neni 7

Ortaku duhet të bëjë përpjekje për rritjen e potentialit ekonomik të shoqërisë, të ruajë sekretin e saj dhe të mos dëmtojë interesat e personave të tjera.

DREJTIMI I SHOQERISE

Neni 8

Shoqëria do të drejtohet nga administratori i saj, ortaku i vetëm themelues i shoqërisë, z. Artur Gela.

Neni 9

Të ardhurat neto të shoqërisë i takojnë ortakut të vetëm themelues të shoqërisë.

Neni 10

Administratori cakton edhe administratorë të tjera të vlerave matérjale të shoqërisë. Ai ka të drejtë të caktojë financierë, likuidator për problemet e shoqërisë, si edhe të pajtojë persona të tjera si ortakë. Financieri nxjerr rregullisht treguesit finanziar tre-mujore, gjashtë-mujorë dhe vjetore, për aktivitetin e kryer të shoqërisë.

Neni 11

Konfliktet që mund të lindin midis palëve do të gjykohen në Gjykatën e Rrethit Tepelenë, sipas statutit të shoqërisë, kontratës të lidhur me palët dhe në zbatim të legjisacionit shqiptar.

Neni 12

Shoqëria ka vulen e saj me madhësi të zakonshme, me tekstin për

rrrethin e saj,



Shoqëria deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe veçanërisht të Ligjit Nr.7638 datë 19.11.1992 "Mbi krijimin e shoqërive tregëtare".

Neni 14

Ky akt themelimi do të hyjë në fuqi pas marrjes së lejes nga organet kopetente.

Neni 15


Akti i themelimit u përpilua në disa kopje për t'iu shpërndarë organeve kopetente dhe një kopje do të mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë tregëtare private "A D A " sh.p.k.

Akti i themelimit nënshkruhet rregullisht nga ortaku themelues.


ORTAKU THEMELUES I SHOQERISE

"A D A " sh.p.k.

Artur Gela



S T A T



I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR" A D A "

Unë Artur Sela,i biri i Bektashit,Datëlindja 1965,banues në Tepelenë,Lagja "Mustafa Matohiti",Pallati 36,vendosa të miratojë statutin e shoqërisë tregëtare private " A D A "sh.p.k. si vijon:

KREU I PARE

EMERTIMI,SELIA, KOHEZGJATJA,KAPITALI ,OBJEKTI.

Neni 1

Shoqëria emërtohet " A D A "sh.p.k.

Neni 2

Selia e shoqërisë private " A D A "sh.p.k.do të jetë në Tepelenë,Lagja "Mustafa Matohiti",Pallati 36.

Neni 3

Kohëzgjatja e shoqërisë është mbi 10 vjet.Shoqëria e fiton personalitetin e vet nga momenti i rregjistrimit në rregjistrin tregëtar,pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë.

Neni4

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë 100.000 lekë,pronë e ortakut të vetëm.Kapitali fillestar i shoqërisë mund të ndryshohet sipas vendimit të ortakut të vetëm themelues të shoqërisë.

Neni 5

Objekti i veprimitarisë së shoqërisë do të jetë në fushën e:
-Tregëtimit të mallrave të ndryshëm industriale dhe ushqimore,
-Tregëtimit të artikujve elektro-shtëpiake,
-Tregëtimit të artikujve bujqësorë e blegtorale,
-Tregëtimit të karburanteve dhe lubrifikanteve,
-Transport për të tjerët,
-Me shumicë e pakicë dhe import eksport,për gjithë artikujt.

KREU I DYTE

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE

Neni 6

Ortaku i vetëm është organi më i lartë i shoqërisë.

Neni 7

- Hyjnë brenda detyrave dhe kopetencave të ortakut të vetëm si më poshtë:
1. Ndryshimi i aktit të themelimit dhe i statutit të shoqërisë.
 2. Miratimi i buxhetit vjetor,i raporteve të administritisit,i inventareve dhe i bilancit dhe llogarisë
 3. Zgjedhja e administratorëve jo-ortakë dhe caktimi i detyrave dhe i kopetencave të tyre,me përjashtim të atyre që shënohen në statut.
 4. Aprovimi i garancive që ka shoqëria.
 5. Miratimi i çmimeve përmallrat që trajton shoqëria,si edhe i tarifave të shërbimeve të saj.
 6. Pranimet në punë dhe largimet nga puna.
 7. Caktimi i vullës dalluese të shoqërisë.
 8. Kryerja e të gjitha veprimeve të administritimit të shoqërisë në emër,për llogari dhe për interes të saj.



Administratori jo-ortak përvetë detyrave që i caktos ortaku i vetëm ka edhe këto detyra dhe të drejta:

1. Të mirëadministrojë pasurinë e shoqërisë.
2. Të bëjë marrëveshje me të tretët brenda objektit të veprimtarisë së shoqërisë dhe kopetncave të caktuara nga ortaku i vetëm.
3. Të zbatojë rregulloren e brendëshme të shoqërisë.
4. Të përgjigjet për dëmet që i sjell shoqërisë nga veprimet e tij.
5. Të paguhet për punën e kryer në bazë të marrëveshjes së bërë me ortakun e vetëm.
6. Të marrë të dhëna dhe të bëjë propozime për gjithçka që e çmon të dobishme për shoqërinë.

KREU I TRETE

TE DREJTAT DHE DETYRAT E SHOQERISE

Neni 9

Shoqëria ka të drejtë:

1. Të importojë dhe të eksportojë mallra në bazë të interesave që ka në përputhje me objektin e veprimtarisë së saj.
2. Të sigurojë pasurinë e vet.
3. Të marrë kredi në lekë dhe në valutë nga bankat vendase dhe të huaja në bazë të rregullave ligjore.
4. Të përfitojë nga favoret që i njeh legjicioni shqiptar lidhur me tatimet dhe të tjera.
5. Të investojë kudo në Shqipëri, nga të ardhurat që realizon gjatë ushtrimit të aktivitetit të saj.
6. Të punësojë punëtorë të thjeshtë ose të kualifikuar, vendas ose të huaj.
7. Të eksportojë lirisht valutën që ka realizuar nga fitimet e saj .

Neni 10

Shoqëria ka për detyrë:

1. Të sigurojë kapitalin themeltar në formën dhe kohën e duhur.
 2. Të japë garanci për mallrat që trajton dhe shërbimet që kryen.
 3. Të sigurojë punonjësit e saj.
 4. Të plotësojë detyrimet fiskale dhe sociale që ka ndaj shtetit, si edhe detyrimet kontraktuale ndaj cilitdo.
5. Të respektojë standartet shtetërore si edhe të gjitha rregullat që lidhen me veprimtarinë e saj.

KREU I KATERT

MARREDHENIET EKONOMIKO-FINANCIARE TE SHOQERISE

Neni 11

E gjithë veprimitaria e shoqërisë për plotësimin e objektit të veprimitarisë së saj, pasqyrohet në bilancin ekonomiё të saj.

Neni 12


Në selinë e shoqërisë mbahet dokumentacioni finanziar, në bazë të të cilis, brenda datës 31 Mars të çdo viti nxirret bilanci.

Neni 13

Viti finanziar fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor.

Neni 14

Shoqëria mban xhiro-llogaritë në Bankën Kombëtare Tregëtare shqiptare. Llogaritë mbahen në lekë dhe pasqyrohen në librat përkatëse.



Nga fitimet e realizuara gjatë vitit finanziar, shoqëria, pasi bën zbritjet e humbjeve të vitit të mëparshëm, lë mënjanë 5% të fitimit, se të cilin krijohet fondi "Rezervë e domosdoshme", deri sa ky fond të arrijë në masën 10% të kapitalit themeltar.

Neni 16

Ortakut të vetëm i takon fitimi neto që realizon shoqëria.

KREU I PESTE

DISPOZITA TE VESANTA

Neni 17

Shoqëria ka vulen e vet dalluese.

Neni 18

Për plotësimin e nevojave të veta shoqëria mund të punësojë punëtorë të thjeshtë ose të kualifikuar, vendas ose të huaj.

Me sejcilin punonjës lidhet kontrata individuale e punës, në bazë të legjisacionit që rregullon marredhëniet e punës. Në kontratë shënohen detyrat dhe detyrimet reciproke. Për personat që do të merren në punë me detyra të veçanta lidhen kontrata individuale.

Neni 19

Në selinë e shoqërisë mbahet një rregjistër i posaçëm, në të cilin pasqyrohen vendimet që merr ortaku i vetëm si edhe administratorët jo-ortakë.



Neni 20

Në marrëdhëniet me të tretët shoqëria tregëtare private " A D A "sh.p.k. përfaqësohet nga administratori i saj z.Artur Sela,i cili në raste të veçanta mund të autorizojë persona të tjerë për ta përfaqësuar atë.

Neni 21

Mosmarreveshjet që mund t'i lindin shoqërisë me persona fizikë ose juridikë,zgjidhen nga gjykatat shqipëtare,përveç se në ato raste kur në kontratë është parashikuar ndryshe.

KREU I GJASHTË

SHNDRRIMI, SHPERBERJA DHE PRISHJA E SHOQERISE

Neni 22

Shndrrimi i shoqërisë " A D A "sh.p.k. në shoqëri të tipeve të tjera,kolektive ose me drejtim të thjeshtë,mund të bëhet vetëm me vendim të ortakut të vetëm.

Neni 23

Shpërbërja e shoqërisë mund të vij në çdo kohë dhe për çfardo shkaku,si:

- Humbja e kapitalit të shoqërisë,
- Pamundësi veprimi,
- Me vendim të ortakut të vetëm.

Në këto raste,pronari i shoqërisë vendos mbi mënyrën e likujdimit dhe cakton një ose më shumë likuidatorë duke iu përcaktuar dhe detyrat.

Administratori dhe likuidatori janë përgjegjës për rruajtjen e pasurisë së shoqërisë përderisa ajo t'u dorëzohet personave

përkatës fizië ose juridië, duke likujduar në rradhë të parë detyrimet ndaj personave të tretë që ka shoqëria.

Në rast se fondet disponibël, rezultojnë të pamjaftueshme, për shlyerjen e detyrimeve të shoqërisë, likuidatori mund t'i kërkojë ortakut themelues të shoqërisë që të derdhë kuotat që i takojnë atij respektivisht.

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 25

Përsa nuk është shprehur plotësisht në këtë statut, referohen plotësimet që do të bëhen nga ortaku i vetëm themelues, si edhe ligjeve të veçanta të legjisacionit shqiptar.


Ndryshimet e plotësimet e këtij statuti bëhen me mënyrën dhe procedurën me të cilën nxirret statuti.

Neni 25

Ky statut përpilohet në disa kopje për t'iu shpérndarë organëva kopetente dhe një kopje mbetet në dokumentacionin bazë te shoqërisë tregëtare private " A D A " sh.p.k.

ORTAKU I VETEM THEMELUES I SHOQERISE

" A D A "sh.p.k. Artur Sela



REPUBLIKA E SHQIPERISE

NOTERIA E TIRANES

Nr. 604. Rep

Tiranë më 1997

Nr. 604. Köl

VERTETIM

Vërtetohet se statuti i shoqërisë tregëtare private " A D A " sh.p.k. nënshkruhet prej ortakut themelues z. Artur Sela në prezencën time dhe unë notere duke e gjetur atë të rregullt e nënshkruaj si më poshtë.



14763/1

K E R K U E S E

38 MUR 2005
ADDEGJOSHOR 2005
TIRANE



KERKUES :

Shoqeria "ADA" sh.p.k e perfaqesuar nga Ortaku i Vetem dhe administratori i saj Artur Çela.

OBJEKTI :

Depozitimi i Vendimit nr. 1 te dates 30.04.2005 te Ortakut te

BAZA LIGJORE :

Vetem shoqerise "ADA" sh.p.k.

Ligji 7667 date 28.01.1993 "Per shoqerite tregetare si dhe per rregjistrin e formalitetet qe duhet te plotesohen ne te."

PERPARA GJYKATES SE RRETHIT TIRANE

Shoqeria me perjegjesi te kufizuar "ADA" eshte rregjistruar si person juridik me vendimin nr.17763 date 22.09.1997, me ortak te vetem dhe administrator Artur Çela, me seli ne Tepelene, me kapital fillestar 100.000 leke dhe kohezgjatje mbi 10 vjet.

Me vendimin nr.1 date 30.04.2005 te Ortakut te Vetem dhe administratorit te shoqerise eshte vodosur :

Zmadhimi i kapitalit te shoqerise me kontribute ne para te vete ortakut qe vijne nga fitimi i akumuluar i shoqerise sipas bilancit perkates.

Caktimin e ekspertit kontabel Zaho Kuka.

Kerkesi i depozitohen aktet dhe te pasqyrohen prane Skedes se Rregjistrimit te kesaj shoqerie duke u bere ndryshimet perkatese si dhe te caktohet nje ekspert kontabel per te caktuar vleren e sakte te fitimit te akumuluar qe do te kaloje per shtimin e kapitalit.

KERKUESI
Artur Çela

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA TIRANE
Nr. 510 Rep.

VERTEtim

dt 30.4.05

Vertetoj se sot ne daten 30.04.2005 para meje noterit u paraqit kerkuesi Artur Çela, Ortak i Vetem dhe administrator i shoqerise "ADA" sh.p.k., i cili deklaroj se sa mes siper eshte hartuar me vullnetin e tij te lire dhe te plote dhe une noteri e vertetoj sipas ligjit.

NOTER
Nezir Muhameti